

Kalimi nga ekuivalenca në pajtueshmëri sipas Rregullores Organike të re të BE-së (Reg. (BE) 2018/848, Reg. (BE) 2021/1698)

Rregullorja e re organike për vendet anëtare të BE-së ka hyrë në fuqi më 01.01.2022, ndërsa për operatorët në vendet jashtë BE do të ketë një afat kohor të ndërmjetëm deri më 31.12.2024 për të kaluar në certifikimin sipas rregullores së re. Rregullorja e re synon garantimin e konkurrencës së ndershme për prodhuesit, parandalimin e mashtrimit dhe rritjen e besimit të konsumatorëve për produktet organike. Ajo përbëhet nga dokumenti bazë Rregullorja (BE) 2018/848, si dhe legjislacioni dytësor (të ashtuquajturat akte deleguese dhe zbatuese). Një përmbledhje të rregulloreve të zbatueshme mund ta gjeni në faqen e internetit të bio.inspecta-s [Përmbledhje e rregulloreve Organike](#).

1. Periudha e tranzicionit për kalimin në rregulloren e re për operatorët e vendeve jashtë BE

Të gjithë klientët e bio.inspecta-s, të certifikuar aktualisht sipas bi-OS do të kalojnë në certifikim sipas rregullores së re. Nga 1 Janari 2024, inspektimet do të bëhen sipas Rregullores së re. Deri atëherë, COI-të do të lëshohen sipas nenit 57 të Rregullores (BE) 2018/848, siç deklarohet në COI në TRACES, kutia 18: Kjo është për të vërtetuar se kjo certifikatë është lëshuar në bazë të kontrolleve të kërkuara sipas Rregullores (EU) 2021/1698 (2) për pajtueshmëri (neni 46 i Rregullores (BE) 2018/848) ose Rregullorja (EU) 2021/1342 (3) për ekuivalencë (neni 47, 48 ose 57 i Rregullores (BE) 2018/848) dhe se produktet e përcaktuara më sipër janë në përputhje me kërkesat e Rregullores (BE) 2018/848.

2. Cilat janë ndryshimet kryesore në rregulloren e re?

2.1 Dispozitat e përgjithshme

- Përveç vendeve me marrëveshje tregtare, rregullorja e re është e detyrueshme edhe për vendet jashtë BE. Certifikimi nuk do të jetë më sipas standardeve ekuivalente nga organet e certifikimit (p.sh. bi-OS), por sipas rregullores së BE-së.
- Rritet gama e produkteve që mund të certifikohen. Janë shtuar p.sh., kripa, dylli i bletës, pambuku, leshti, krimbi i mëndafshit, vajrat esencialë (gjithashtu dhe ato që nuk janë të destinuara për konsum ushqimor).
- Një operator ose një grup operatorësh nuk mund të certifikohet nga më shumë se një trupë kontrolli në lidhje me aktivitetet për të njëjtën kategori produktesh (p.sh. prodhim/përpunim).
- Rregullorja e re është më specifike dhe i jep më shumë rëndësi detyrës së operatorëve të certifikuar për të marrë masa parandaluese në çdo fazë të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes për të shmangur kontaminimin dhe përzierjen me produkte ose substanca të paautorizuara. Operatorët duhet të zhvillojnë një sistem sigurimi të cilësisë me masa që janë proporcionale dhe të përshtatshme për të identifikuar dhe shmangur rreziqet e kontaminimit dhe përzierjes. Masat duhet të rishikohen dhe përshtaten rregullisht.
- Operatorët duhet të kenë një sistem të vetëkontrollit (p.sh. sistemi i menaxhimit të cilësisë). Trupat e kontrollit duhet të kontrollojnë sistemin e operatorëve të certifikuar dhe të vlerësojnë efikasitetin e tij.

2.2 Prodhimi bimor

2.2.1 Prodhimi bimor i lidhur me tokën

- Rregullorja e re është më specifike rreth kërkesave për prodhimin e bimëve të lidhura me tokën. Kultivimi i kulturave duhet të bëhet në tokë ose në tokë që është e përzier ose e plehëruar me materiale dhe produkte që lejohen në prodhim organik në lidhje me nëntokën dhe shkëmbinjtë (përfshihen ato bimë që rriten natyrshëm në ujë). Prodhimi hidroponik mbetet i ndaluar.
- Kultivimi i bimëve në vazo lejohet në rastin e bimëve zbukuruese dhe barishtore që do të shiten së bashku me vazon të konsumatori përfundimtar dhe për rritjen e fidanëve ose transplantet në module për transplantim të mëtejshëm.

2.2.2 Farat dhe materialet e tjera riprodhuese bimore

- Materiali mbjellës (duke përfshirë farat dhe materialin shtues vegjetativ si copat, farat e patateve, nënshartesa) duhet të jetë me origjinë organike, në rast të mungesës së tyre në vendin e operatorit, trupa e kontrollit mund të japë miratimin për përdorimin e farave konvencionale (si më parë, miratimi duhet të merret para mbjelljes). Fara në cilësinë "në kalim" mund të blihen gjithashtu. Në një rast të tillë, duhet të sigurohen dëshmi se nuk ka material organik gjendje. Provat do të verifikohen gjatë kontrollit. Përjashtimi nuk mund të jepet për fidanët me cikël kultivimi në një sezon (nga koha e transplantimit të fidanit deri në vjeljen e parë të produktit). Fidanët e tillë duhet të jenë në statusin organik.

2.2.3 Menaxhimi i tokës dhe plehërimi

- Është e detyrueshme që një qarkullim bimor të përfshijë kulturat bishtajore si kulturë kryesore ose mbuluese për qarkullimin e bimëve dhe kulturat e tjera të plehërimit të gjelbër (livadhet dhe foragjeret shumëvjeçare janë të përjashtuara nga ky detyrim).
- Për kulturat shumëvjeçare të ndryshme nga ato foragjere ose kulturat në serrë, duhet të përdoren kulturat afatshkurtër të plehërimit të gjelbër dhe bishtajoret. Përveç kësaj, pjelloria e tokës duhet të ruhet dhe të rritet përmes shumëllojshmërisë së bimëve të kultivuara.
- Në të gjitha rastet, pjelloria e tokës duhet të ruhet me aplikimin e plehut organik të bagëtive ose lëndëve organike, të dyja mundësisht të kompostuara, nga prodhimi organik.
- Njëlloj si më parë, plehurat dhe ushqyesit e ndryshëm të tokës nga jashtë mund të përdoren vetëm nëse kërkesat për lëndë ushqyese të bimëve nuk mund të mbulojnë nga lëvrimi dhe kultivimi, qarkullimi bimor, aplikimi i plehut organik të bagëtive ose lëndëve organike.
- Substancat e lejuara janë të renditura në Reg. (BE) 2021/1165, Aneksi II. Lista është e ngjashme me Aneksin I të bi-OS.

2.2.4 Mbrojtja e bimëve

- Me rregulloren e re përveç substancave aktive të listuara, të gjithë mbrojtësit, sinergjikët, ko-formulantët dhe adjuvantet sipas Reg. (EC) 1107/2009 (ligji i përgjithshëm për mbrojtjen e bimëve të BE-së) janë të lejuara.
- Më shumë theks i kushtohet "masave parandaluese". Kultivimi do të përfshijë parimin e ruajtjes së bimëve me masa parandaluese, në veçanti zgjedhjen e specieve të përshtatshme, varieteteve ose materialit heterogjen rezistent ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve, qarkullimin bimor, metodat mekanike dhe fizike dhe mbrojtjen me anë të armiqëve natyror të dëmtuesve. Vetëm nëse masat parandaluese nuk janë të mjaftueshme për të mbrojtur bimët, atëherë mund të përdoren substancat e lejuara të listuara në Reg. (BE) 2021/1165, Shtojca I. Lista është e njëjtë me Aneksin II të bi-OS.

2.2.5 Pastrimi dhe dezinfektimi

- Lista e produkteve për pastrimin dhe dezinfektimin e ndërtesave dhe instalimeve të përdorura për prodhimin e bimëve, duke përfshirë ruajtjen është planifikuar të publikohet në vitin 2024. Deri atëherë, nuk ka ndryshime në procedurën bio.inspecta.

2.3 Grupet e operatorëve

2.3.1 Struktura e grupit

- Grupet e fermerëve duhet të kenë një personalitet juridik.
- Kërkesat që një fermer të bëhet anëtar i grupit janë si më poshtë:: Kostoja individuale e certifikimit përfaqëson më shumë se 2% të xhiros së secilit anëtar dhe qarkullimi vjetor i prodhimit organik nuk duhet të jetë më shumë se 25'000 euro ose fermer i cili ka në zotërim maksimumi:
 - 5 hektarë;
 - 0,5 hektarë, në rastin e serave
 - 15 hektarë, në rastin e kullotave të përhershme.
- Numri maksimal i një grupi duhet të jetë 2000 anëtarë. Grupet më të mëdha do të duhet të krijojnë grupe të reja (maksimumi 2000 anëtarë, përfaqësues individual juridik). Grupet e operatorëve të certifikuar sipas rregullores së mëparshme për të cilët nevojiten ndryshime të rëndësishme administrative, ligjore dhe strukturore në lidhje me numrin maksimal të operatorëve kanë një periudhë kalimtare deri më 31.12.2025.
- Një anëtar i një grupi duhet të regjistrohet vetëm me një grup operatorësh për një produkt të caktuar, edhe në rastet kur operatori është i angazhuar në aktivitete të ndryshme (prodhim, përpunim) por që kanë lidhje po me atë produkt.
- Një grup operatorësh nuk mund të marrë certifikatë nga më shumë se një trupë kontrolli për aktivitetet me të njëjtën kategori produktesh, duke përfshirë edhe rastet në të cilat ai grup operatorësh operon në faza të ndryshme të prodhimit, përgatitjes dhe shpërndarjes.

2.3.2 Detyrat e menaxherit dhe inspektorëve të ICS-së

- Detyrat e menaxherit dhe inspektorëve të ICS-së tani janë të përcaktuara qartë në Rregullore. Menaxheri dhe inspektorët e ICS-së mund të jenë anëtarë të grupit, por menaxheri nuk mund të jetë inspektor i ICS-së.

2.3.3 Njoftimi i grupit tek trupa e kontrollit

- Menaxheri i ICS-së duhet të njoftojë menjëherë trupën e kontrollit në rast të:
 - çdo dyshim për jokonformitete madhore dhe kritike;
 - çdo pezullim ose tërheqje nga grupi të një anëtari ose një njësie prodhimi ose ambientesh, duke përfshirë qendrat e blerjes dhe grumbullimit;
 - çdo ndalim i vendosjes në treg së një produkti organik ose në kalim, duke përfshirë emrin e anëtarit ose anëtarëve, sasi të përkatëse dhe lot-in.

2.3.4 Kontrollat e grupit ICS nga trupa e kontrollit

- Trupat e kontrollit duhet të vizitojnë çdo vit 5% të anëtarëve të një grupi dhe për çdo vit të marrin të paktën mostër për analizë nga 2% e anëtarëve.

2.3.5 Masat në rast se ICS nuk është efektive

- Në rastet kur konstatohen mangësi në organizim ose funksionimin e sistemit të ICS-së, veçanërisht në lidhje me mos efikasitetin për të zbuluar mospërpunueshmërinë nga anëtarët individualë të grupit që cenojnë integritetin e produkteve organike, certifikata e grupit duhet të tërhiqet.

2.4 Ushqim i përpunuar

2.4.1 Nanomateriale të projektuara

- Projektimi me qëllim të caktuar i nanomaterialeve është i ndaluar (madhësia e grimcave <100 nm). Nanomaterialet natyrale nuk përfshihen në këtë kufizim.

2.4.2 Përbërësit bujqësor jo organike

- Lista e përbërësve bujqësorë jo organik të lejuar është reduktuar në pak produkte (këto produkte mund të jenë vetëm deri në 5% të totalit të përbërësve bujqësorë në produktin e certifikuar). Produktet janë të listuara në Reg. (BE) 2021/1165, Shtojca V, Pjesa B.

2.4.3 Aromatizuesit

- Përdorimi i aromatizuesëve konvencionale është më i kufizuar. Të lejuara janë produktet e etiketuara si substanca dhe preparate natyrale aromatizuese. Pjesa e aromës duhet të merret ekskluzivisht ose të paktën 95% (w/w) nga materiali bazë i përdorur në emër, p.sh. "aromë natyrale limoni" nga limoni. 5% që nuk është marrë nga materiali bazë mund të përdoret vetëm për standardizim ose për të dhënë një shënim specifik.

2.4.4 Pastrimi dhe dezinfektimi

- Lista e produkteve për pastrimin dhe dezinfektimin për objektet e përpunimit dhe depozitimit është planifikuar të publikohet në vitin 2024. Deri atëherë nuk ka ndryshime në procedurën bio.inspecta.

2.5 Blegtoria

2.5.1 Qëllimi

- Specie që mund të certifikohen i janë shtuar kërpudhat dhe lepujt.

2.5.2 Barngrënësit

- Kërkesa minimale e ushqimit nga vetë ferma do të rritet nga 60% në 70% që nga 01.01.2024.
- % maksimale e ushqimit në konvertim viti 2 të blerë, i lejuar në racionin ushqimor reduktohet nga 30% në 25%.
- Nëse ushqimi i kafshëve me qumështin e nënës nuk është i mundur, zëvendësuesi i qumështit duhet të jetë 100% organik

2.5.3 Shpendët

- Blerja e zogjve të rritur në mënyrë jo organike mund të bëhet vetëm për zogjtë <3 ditor (nuk mund të blihen më zogj jo organik <18 javë).
- Kërkesa minimale për ushqim nga vetë ferma rritet nga 20% në 30%.
- % maksimale e ushqimit në konvertim viti 2 të blerë, i lejuar në racionin ushqimor reduktohet nga 30% në 25%.

- Për shpendët për majmëri të ndryshme nga Gallus gallus: kërkohet ndarja e plotë fizike nga dyshemeja në çati. Për Gallus gallus: ndarjet duhet të behen me anë të ndarjeve të forta ose gjysmë të forta, rrjetave ose laqeve. Zonat e hapura duhet të jenë të ndara në atë mënyrë që zogjtë nga tufa të ndryshme të mos përzihen.
- Periudha e konvertimit për zonën e hapur është 1 vit, nuk është më i mundur konvertimi në 6 muaj.
- Gjitha zona duhet të ketë një shumëllojshmëri bimësh, pemësh dhe shkurresh.
- Zonat e hapura nuk duhet të jenë më larg se 150 m nga vendet e hyrje/daljes. Shtrirja e zonës së hapur deri në 350 m do të jetë e pranueshme nëse zona ka mjaftueshëm strehëza (minimumi 4 strehë/ha) ku shpendët mbrohen nga moti dhe grabitqarët.
- Rregullorja e re përcakton përdorimin e verandave. Verandat përkufizohen si një pjesë e jashtme shtesë, e një ndërtese e destinuar për shpendët e mbuluar me çati, e paizoluar, pjesa më e madhe zakonisht është e pajisur me gardhe teli ose rrjetë, me një ajrim dhe ndriçim natyral dhe, kur është e nevojshme, edhe artificial, si dhe dysheme me shtrojë. Veranda nuk konsiderohet zonë e hapur. Prandaj nuk merret parasysh në llogaritjen e densitetit të stokut dhe të zonave minimale të jashtme. Te shpendët për majmëri, sipërfaqja e verandës nuk llogaritet me sipërfaqen totale të shfrytëzueshme të shtëpive të shpendëve (maksimumi 1600 m²).

2.5.4 Bletaria

- % e lejuar e blerjes së mbretëreshave dhe tufave joorganike është rritur nga 10% në 20% për vit.
- Zhvendosja e koshereve në zona jo të lejuara për qëllime pjalmimi nuk lejohet me. Zhvendosja e koshereve në zona jo të lejuara mund të jetë e mundur vetëm nëse është dhënë leje nga trupa e kontrollit dhe në rast të fatkeqësive (tërmete, zjarre, etj.) që reduktojnë në mënyrë drastike burimet e nektarit dhe polenit dhe kërcënojnë mbijetesën e kolonisë.

2.6 Sistemi i kontrollit

2.6.1 Investigimi zyrtar

- Si në rregulloren e mëparshme, në rast dyshimi për substanca të pa lejuara në produktet organike, duhet të kryhet një investigim. Tregtimi i produkteve në fjalë dhe përdorimi i tyre në prodhimin organik do të ndalohet përkohësisht deri në përfundim të investigimit. Me rregulloren e re, ky quhet investigim zyrtar. Nëse një trupë kontrolli merr informacion të faktuar në lidhje me substancat e pa lejuara në produktet organike, duhet të fillojë menjëherë një investigim zyrtar. Investigimi duhet të gjejë burimin dhe shkakun e substancës së palejuar.
- Rregullorja e re përshkruan në mënyrë më të detajuar se në cilat raste një produkt do të decertifikohet. Ky është rasti kur hetimi gjen si më poshtë:
Aplikim i drejtpërdrejt i substancave të pa lejuara
Masa parandaluese jo të mjaftueshme (jo proporcionale dhe të përshtatshme)
Operatori nuk ka marrë masa në lidhje me jokonformitetet e mëparshme të identifikuar nga trupa e kontrollit

2.6.2 Jokonformitetet dhe katalogu i masave

- Kategoritë e sanksioneve, bazuar në ashpërsinë e jokonformiteteve sipas bi-OS do të zëvendësohen nga një katalog masash, i cili i klasifikon jokonformitetet në: të vogla, të mëdha dhe kritike

Për çdo pyetje, ju lutemi mos hezitoni të na kontaktoni (contact@bio-inspecta.al).